

LIGJ
NR.8578, DATË 10.2.2000

PËR TEATRIN

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë marrëdhëniet e organizimit, të funksionimit dhe të zhvillimit të sistemit teatror kombëtar.

Neni 2

Përkufizime

Në zbatim të këtij ligji, termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

a) “Teatër” kuptohet ajo çka ndodh në shfaqje të gjallë e të drejtpërdrejtë ndërmjet artistit teatror dhe spektatorit.

b) “Vepër teatrorë” kuptohet krijimi i gjallë artistik i një teksti, platforme, partiture a libreti, të përfunduar dhe të mundshëm për t’u shfaqur për së gjalli dhe drejtpërdrejt në publik.

c) “Veprimtari teatrorë” kuptohet krijimi, prodhimi, ekzekutimi, tregtimi dhe shfrytëzimi i veprës teatrorë, zhvillimi i vlerave kombëtare teatrorë, edukimi teatror dhe shërbimet e lidhura me këtë veprimtari.

ç) “Artistë teatrorë” kuptohen të gjithë ata, vepra e të cilëve është e paracaktuar të komunikojë për së gjalli dhe drejtpërdrejt me një auditor të caktuar.

E gëzojnë këtë cilësi si artistët dhe bashkëpunëtorët e veprës teatrorë, edhe artistët që shfaqen në publik.

d) “Fondi publik i teatrit” kuptohet fondi i miratuar në ligjin vjetor të buxhetit, si dhe të ardhurat e tjera, të njohura me ligj, të paracaktuara për financimin e veprimtarisë teatrorë kombëtare.

dh) “Qendra Kombëtare e Teatrit” është institucioni shtetëror kombëtar, i cili nëpërmjet administrimit të fondit publik të teatrit, bën bashkërendimin, organizimin dhe financimin e veprimtarisë teatrorë në Shqipëri.

e) “Kompani teatrorë” kuptohet personi fizik ose juridik, privat ose shtetëror, vendas ose i huaj, i cili merr përgjegjësinë e realizimit të veprimtarisë teatrorë dhe gëzon cilësinë e pronarit të saj.

ë) “Qendër teatrorë ose qendër arti” kuptohen institucionet publike dhe private, të paracaktuara që më parë si të tilla, të paracaktuara të shërbejnë për edukim, prodhim dhe shfaqje të veprës teatrorë dhe të veprimtarive të tjera artistike.

f) “Projekt teatror” kuptohet çdo ide, e zhvilluar dhe e plotësuar deri në nivelin e shpjegimit të kuptueshëm, duke përfshirë të gjitha elementet e nevojshme për realizimin e saj në cilësinë e veprës teatrorë. Projekti teatror mund të jetë i sferës së prodhimit, të edukimit, të promovimit, tradicional ose alternativ, privat ose shtetëror.

g) “Aplikim” kuptohet kërkesa e kompanisë teatrorë për financimin nga fondi publik i teatrit, mbështetur në rregulloret dhe në tarifat e paracaktuara nga Qendra Kombëtare e Teatrit, për realizimin e

një ose më shumë projekteve teatrore.

gj) “Mbështetje financiare” kuptohet masa e financimit të një projekti teatror dhënë kompanisë teatrore nga fondi publik i teatrit.

KREU II INSTITUCIONET PUBLIKE TË TEATRIT DHE ORGANIZIMI I TYRE QENDRA KOMBËTARE E TEATRIT DHE STRUKTURAT E SAJ

Neni 3

Qendra Kombëtare e Teatrit

Qendra Kombëtare e Teatrit ka selinë, stemën, vulën dhe llogarinë bankare.

Neni 4

Varësia dhe organizimi i Qendrës Kombëtare të Teatrit

Qendra Kombëtare e Teatrit është institucion në varësi të Këshillit të Ministrave. Organizimi, struktura dhe funksionimi përcaktohen në statusin e saj, i cili miratohet nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 5

Detyrat e Qendrës Kombëtare të Teatrit

Qendra Kombëtare e Teatrit ka këto detyra:

a) Zbaton politikat shtetërore në fushën e artit teatror, të miratuara në programin e Këshillit të Ministrave.

b) Zbaton ligjet, aktet nënligjore dhe administrative për funksionimin e veprimtarisë teatrore në Shqipëri.

c) Shpall publikisht, në krye të vitit, fondin publik të teatrit, jo më vonë se 1 muaj pas detajimit të Buxhetit të Shtetit.

ç) Bën ndarjen e fondit publik të teatrit për njësitë e veçanta të veprimtarisë teatrore dhe në bazë të shtrirjes gjeografike të kësaj veprimtarie.

d) Harton rregulloret për mënyrën e paraqitjes së formularëve të aplikimit, të kushteve të kontraktimit, të tarifave të shërbimeve dhe të kuotave të shpërblimit, në bazë të të cilave jepet financimi për projektet e aplikuara dhe të shpallura fituese.

dh) Paraqet çdo vit kërkesat për mbështetje buxhetore në fondin publik të teatrit dhe mbikëqyr përdorimin e financimeve nga kompanitë teatrore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

e) Ndjek dhe realizon bashkëpunimin ndërshtetëror në fushën e veprimtarisë teatrore, mbështetur në konventat ndërkombëtare dhe në marrëveshjet dypalëshe, të nënshkruara nga shteti shqiptar me shtetet e tjera.

ë) Mbledh, përpunon dhe u shpërndan kompanive teatrore dhe subjekteve të tjera të saj informacion të vlefshëm në fushat e prodhimit, të edukimit dhe të promovimit të veprimtarisë teatrore.

f) Nxit dhe financon projekte në fushën e botimit të literaturës dhe të informacionit teatror.

g) Nxit, bashkëpunon, financon dhe bashkëfinancon projekte e programe në fushën e edukimit, të prodhimit dhe të shpërndarjes së veprimtarive teatrore kombëtare dhe ndërkombëtare.

gj) Mbështet dhe financon, plotësisht ose pjesërisht, projekte promovimi, si festivale të teatrit turne, pjesëmarrje ndërkombëtare.

h) Siguron asistencë teknike në shërbim të rritjes cilësore dhe të standardizimit të aplikimit të projekteve teatrore.

i) Përgatit dhe organizon mbledhjen e Këshillit Artistik Kombëtar të Teatrit (KAKT).

j) Regjistron dhe licencon kompanitë teatrore.

Neni 6

Mënyra e zgjedhjes dhe emërimi i Kryetarit të Qendrës Kombëtare të Teatrit

Kryetari i Qendrës Kombëtare të Teatrit emërohet nga Kryeministri, me propozimin e Ministrisë të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Kryetari përzgjidhet ndërmjet 2 fituesve të konkursit publik, të shpallur dhe të organizuar nga Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, sipas kritereve të përcaktuara prej këtij të fundit.

Kryetari i Qendrës Kombëtare të Teatrit emërohet për 4 vjet me të drejtë riemërimi. Ai mund të shkarkohet nga Kryeministri përpara mbarimit të mandatit, vetëm në rast se vërtetohet se ka kryer shkelje kushtetuese dhe ligjore.

Neni 7

Detyrat e Kryetarit të Qendrës Kombëtare të Teatrit

Kryetari i Qendrës Kombëtare të Teatrit ka këto detyra:

a) I paraqet Ministrisë të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve strukturën administrative të Qendrës Kombëtare të Teatrit.

b) Miraton rregulloren e funksionimit të Këshillit Artistik Kombëtar të Teatrit.

c) Miraton projektet teatrore, të klasifikuara nga Këshilli Artistik Kombëtar i Teatrit. Ai ka të drejtë t'i kthejë këto projekte vetëm 1 herë për rishikim në Këshillin Artistik Kombëtar të Teatrit, kur ka vërejtje dhe sugjerime në lidhje me to. Kjo procedurë dhe përfundimet e saj bëhen publike.

ç) Miraton projekte të kufizuara financiarisht, shuma e të cilave nuk kalon 5 për qind të vlerës së përgjithshme të fondit vjetor publik të teatrit, por jo më shumë se 2 projekte në vit.

d) Përfaqëson institucionin dhe gëzon cilësinë e autoritetit shtetëror të teatrit shqiptar.

dh) Nënshkruan kontratat e financimit me kompanitë teatrore për projektet e shpallura fituese.

Neni 8

Caktimi i komisioneve të përkohshme dhe i këshilltarëve

Për projekte dhe nevoja të veçanta, Kryetari i Qendrës Kombëtare të Teatrit ka të drejtë të krijojë komisione të përkohshme ose të marrë bashkëpunëtorë ose këshilltarë të jashtëm.

Shpërblimi i tyre bëhet me honoraret e parashikuara në shpenzimet e projektit, sipas tarifave të përgjithshme, në bazë të të cilave aplikohet për financim.

FONDI PUBLIK I TEATRIT

Neni 9

Shpallja e fondit publik të teatrit

Fondi publik i teatrit shpallet publikisht me miratimin e Buxhetit vjetor të Shtetit.

Neni 10

Mosndryshimi i drejtimit të fondit publik të teatrit

Fondit publik të teatrit nuk mund t'i ndryshohet drejtimi. Ky fond krijohet, përdoret dhe menaxhohet në përputhje me parimet dhe me rregullat e përcaktuar në legjislacionin shqiptar dhe në ligjin nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë".

Neni 11

Burimet financiare të fondit publik të teatrit

Burimet financiare të fondit publik të teatrit janë:

- I. Buxheti i shtetit.
- II. Të ardhura të tjera jobuxhetore nga:
- a) pagesat e regjistrimeve, të licencimeve dhe të shërbimeve të tjera administrative të Qendrës Kombëtare të Teatrit;
 - b) biletat dhe faturat e tjera të shitjes së veprave teatrore, llogaritur në bazë të përqindjes së financimit të përfituar nga fondi publik i teatrit;
 - c) shitjet e botimeve, të katalogëve, të udhëzimeve teatrore etj., të financuara nga fondi publik i teatrit;
 - ç) të ardhurat nga donatorë ose sponsorë të ndryshëm;
 - d) të ardhura të lejuara me ligj.

KËSHILLI ARTISTIK KOMBËTAR I TEATRIT

Neni 12

Këshilli Artistik Kombëtar i Teatrit

Këshilli Artistik Kombëtar i Teatrit (KAKT) është organizëm i pavarur, që vepron pranë Qendrës Kombëtare të Teatrit.

KAKT-i vepron si një forum i vetëm. Ai merr vendimet me shumicë të thjeshtë votash, kur në të marrin pjesë jo më pak se 50 për qind plus një e të gjithë anëtarëve.

Neni 13

Zgjedhja e anëtarëve të KAKT-it

KAKT-i përbëhet nga 11 anëtarë, përfaqësues të shquar të artit kombëtar, me tituj artistikë. Anëtarët e KAKT-it janë përfaqësues të këtyre institucioneve:

- Teatri Kombëtar i Dramës: 2 përfaqësues.
- b) Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit: 2 përfaqësues.
- c) Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve Popullore: 2 përfaqësues.
- ç) Teatri Kombëtar për Fëmijë: 1 përfaqësues.
- d) Teatrot vendore: 2 përfaqësues.
- dh) Teatrot private: 1 përfaqësues.
- e) Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve: 1 përfaqësues.

Neni 14

Kohëzgjatja në detyrë e anëtarëve të KAKT-it

Anëtarët e KAKT-it zgjidhen për një mandat 3-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Ata zgjidhen me votim të fshehtë nga këshillat artistikë të institucioneve teatrore. Ata nuk mund të jenë njëkohësisht drejtues të këtyre institucioneve, kryetarë të këshillave artistikë të tyre ose aksionerë të këtyre institucioneve.

KAKT-i zgjedh me votim të fshehtë Kryetarin dhe zëvendëskryetarin e tij.

Kur një anëtar i KAKT-it largohet për arsye të ndryshme, ai zëvendësohet nga institucioni, të cilit i përkiste anëtari i larguar.

Neni 15

Mbledhjet e KAKT-it dhe shpërblimi

KAKT-i mbledhet të paktën dy herë në vit, në përputhje me rregulloren e funksionimit të tij. Me kërkesë të Kryetarit të Qendrës Kombëtare të Teatrit mbledhet edhe jashtë radhe.

Masa e shpërblimit të anëtarëve të KAKT-i përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 16

Detyrat dhe mënyra e punës së KAKT-it

KAKT-i përzgjedh dhe klasifikon projektet teatrore nga pikëpamja cilësore, kulturore dhe ekonomike.

KAKT-i merr vendim vetëm pasi është njohur me projektin e aplikuar dhe me relacionet e strukturave përkatëse të Qendrës Kombëtare të Teatrit, si dhe pasi ka dëgjuar shpjegimet e aplikuesit.

Vendimi i KAKT-it përfshin miratimin e projektit artistik dhe fondin përkatës financiar.

KREU III

KOMPANIA TEATRORE PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 17

Kuptimi i kompanisë teatrore

Kompani teatrore është çdo person fizik ose juridik, privat ose shtetëror, vendas ose i huaj, që merr nismën dhe përgjegjësinë kulturore, ekonomike, juridike e morale të kryejë veprimtari në fushën e prodhimit, të edukimit dhe të promovimit të artit teatror.

Kompanitë teatrore organizohen dhe funksionojnë sipas statusit të tyre dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 18

Llojet e kompanive teatrore

Kompanitë teatrore mund të jenë qendrore ose vendore, shtetërore ose private, të përkohshme, të rastësishme, të përhershme, individuale ose kolektive.

Neni 19

Statusi i kompanive teatrore shtetërore dhe i punonjësve të tyre

Kompanitë teatrore shtetërore kombëtare janë institucione buxhetore ose shoqëri tregtare shtetërore. Statusi i tyre do të jetë në varësi të formës juridike të funksionimit të tyre.

Neni 20

Marrëdhëniet e kompanive teatrore me Qendrën Kombëtare të Teatrit

Të gjitha kompanitë teatrore janë të barabarta përpara Qendrës Kombëtare të Teatrit dhe të pavarura prej saj.

Klasifikimi dhe përfitimi i financimit mbështeten mbi parimet e barazisë në konkurrim, në vlerat kulturore e kombëtare, si dhe mbi efektivitetin ekonomik të projektit.

Neni 21

Kushtet për gëzimin e së drejtës së aplikimit

Kompania teatrore gëzon të drejtën e aplikimit për financim nga fondi publik i teatrit vetëm pasi është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Teatrit dhe ka deklaruar pranimin e rregullave, të tarifave dhe të kuotave të shpërblimit të shpallura prej saj.

Neni 22

Llojet e financimeve nga Qendra Kombëtare e Teatrit

Kompania teatrore ka të drejtë të kërkojë nga Qendra Kombëtare e Teatrit financim të pjesshëm ose të plotë për një projekt të vetëm teatror, për një projekt stinor teatror, deri për një projekt

vjetor.

Kompanitë teatrale shtetërore qendrore kanë të drejtë ekskluzive të paraqitjes së projektit vjetor teatror dhe të përfitimit nga fondi publik i teatrit të subvencionit të plotë për projektin e miratuar nga KAKT-i.

Neni 23

Kushtet e funksionimit

Kompania teatrale është e lirë të kontraktojë shërbimet e projektit në kushtet e tregut. Ajo është e lirë të kontraktojë artistë dhe bashkëpunëtorë, në bazë të ofertë-kërkesës.

Për financimin e përfituar nga fondi publik i teatrit, ajo është e detyruar të pranojë kuotat dhe tarifat e Qendrës Kombëtare të Teatrit.

Neni 24

Shlyerja e detyrimeve të financimit

Pasi ka shlyer detyrimet që burojnë nga financimi, parashikuar në kontratën e saj me Qendrën Kombëtare të Teatrit, kompania teatrale gëzon të drejtën e pronësisë ekonomike dhe të përdorimit të lirë të veprës teatrale.

Neni 25

Kuota e shpenzimeve administrative

Shpenzimet administrative të një projekti teatror të financuar nuk duhet të kalojnë 10 për qind të të gjithë vlerës së financimit.

Neni 26

Mosndryshimi i drejtimit të fitimit të siguruar nga veprimtaria teatrale e financuar

Të gjitha të ardhurat e siguruara nga shitja e veprës teatrale, të realizuara me pjesëmarrjen e financimit të fondit publik të teatrit, kompania teatrale është e detyruar t'i përdorë në projektin e ardhshëm teatror. Në rast shkeljeje të këtij detyrimi, kompania teatrale humbet të drejtën për të përfituar financim të ri nga ky fond.

KOMPANITË TEATRORE SHTETËRORE QENDRORE

Neni 27

Qëllimi i kompanisë teatrale shtetërore qendrore

Qëllimi i kompanisë teatrale shtetërore qendrore është nxitja, stimulimi dhe përparimi i artit teatror, si krijimtari shpirtërore e popullit dhe ruajtja e identitetit kombëtar kulturor, nëpërmjet studimit, edukimit dhe paraqitjes së veprës teatrale, klasike dhe bashkëkohore, eksperimentimit të formave të reja teatrale, realizimit të veprave për të gjitha grupet e shtresat sociale, shkëmbimeve teatrale ndërkombëtare, turneve, manifestimeve intelektuale, riprodhimit audioviziv të veprës teatrale, botimeve etj.

Neni 28

Varësia e kompanive teatrale shtetërore qendrore

Kompanitë teatrale shtetërore qendrore, të krijuara ose të shndërruara në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në zbatim të këtij ligji, janë institucione publike në varësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 29

Burimet financiare të kompanisë teatrore shtetërore qendrore

Burimet financiare të kompanisë teatrore shtetërore qendrore janë:

Buxheti i Shtetit për shpenzimet e administratës.

b) Të ardhurat e siguruara nga projektet e saj, të shpallura fituese nga Qendra Kombëtare e Teatrit.

c) Të ardhurat nga shitjet e veprës së saj teatrore.

ç) Të ardhurat nga shërbimet që kompania u bën të tretëve.

d) Sponsorizimet e donacionet.

Neni 30

E drejta e selisë

Kompanitë teatrore shtetërore qendrore i kanë selitë e tyre në godinat e qendrave kombëtare të artit, në përputhje me përkatësinë e tyre artistike e funksionale.

Neni 31

Zgjedhja e drejtorit

Kompania teatrore shtetërore qendrore udhëhiqet nga drejtori, i cili emërohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrisë të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Drejtori propozon statutin dhe strukturën organizative të administratës së tij, të cilat miratohen nga Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 32

Këshilli artistik i kompanive shtetërore teatrore

Veprimtaria e kompanive shtetërore teatrore qendrore dhe vendore organizohet në bazë të statutit të tyre. Ky statut propozohet nga këshilli artistik i kompanisë teatrore përkatëse dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Veprimtaria artistike e kompanive teatrore udhëhiqet nga këshillat artistike. Këto zgjidhen me votim të fshehtë nga trupa artistike e institucionit përkatës. Procedurat e zgjedhjes, kompetencat e tyre, numri i anëtarëve dhe afati i zgjatjes së mandatit përcaktohen në statutin e tyre.

KOMPANITË TEATRORE SHTETËRORE VENDORE

Neni 33

Statusi i kompanive teatrore shtetërore vendore dhe varësia e tyre

Kompanitë teatrore shtetërore vendore janë institucione buxhetore ose shoqëri tregtare, që krijohen ose shndërrohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në zbatim të këtij ligji, me nismën, vullnetin e pushtetit vendor dhe janë në vartësi të këtij pushteti.

Statusi i kompanive teatrore shtetërore vendore propozohet nga këshillat artistikë dhe miratohet nga këshillat e bashkive përkatëse, sipas një statuti tip të miratuar nga Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 34

Burimet financiare të kompanisë teatrore shtetërore vendore

Burimet financiare të kompanisë teatrore shtetërore vendore sigurohen nga:

a) buxheti i shtetit për pushtetin vendor për shpenzimet administrative;

buxheti i pushtetit vendor për kulturën;

- c) të ardhurat e siguruara nga projektet fituese në Qendrën Kombëtare të Teatrit;
- ç) të ardhurat nga shitja e veprës teatrore;
- d) të ardhura nga shërbimet, që kompania teatrore u bën të tretëve;
- dh) sponsorizimet e donacionet.

Neni 35
E drejta e selisë

Kompanitë teatrore shtetërore, vendore e kanë selinë në qendrën vendore të artit.

Neni 36
Zgjedhja e drejtorit

Drejtori i kompanive shtetërore vendore emërohet nga strukturat përgjegjëse të pushtetit vendor. Procedurat e emërimit të tij përcaktohen në statutin tip.

Neni 37
Kontraktimi i artistëve teatrorë

Artistët teatrorë hyjnë në marrëdhënie kontraktuale me kompaninë teatrore shtetërore vendore sipas nevojave, përmasave të veprimtarisë teatrore, suksesit të repertorit, brenda fondit financiar të përfutur.

KREU IV
QENDRA TEATRORE OSE QENDRA E ARTIT

Neni 38
Kuptimi i qendrave teatrore ose i qendrave të artit

Qendrat teatrore janë institucionet shtetërore ekzistuese ose ato që do të krijohen në të ardhmen, që kanë kapacitetet dhe infrastrukturën fizike dhe administrative të domosdoshme për shërbimet e prodhimit, të edukimit, të shpërndarjes, të promovimit dhe të shfaqjes së veprës teatrore dhe të veprave të tjera, artistike e kulturore.

Qendrat e artit mund të emërtohen edhe në cilësinë e një arti të vetëm ose mund të mbajnë emërtime të tjera, të zgjedhura në përputhje me funksionet e kësaj qendre.

Neni 39
Pronësia e qendrave ekzistuese të artit

Qendrat ekzistuese të artit janë pronë shtetërore. Qendrat qendrore janë në pronësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, ndërsa qendrat vendore janë në pronësi të pushtetit vendor.

Neni 40
Marrëdhëniet e qendrave të artit me të tretët

Qendra e artit hyn në marrëdhënie kontraktore, shërbimi e bashkëpunimi me kompanitë teatrore dhe me persona të tjerë, fizikë e juridikë, që ushtrojnë veprimtari artistike e kulturore për projekte të veçanta ose stinore.

Qendra e artit, në përputhje me ofertë-kërkesën dhe me lëvizjet e tregut, harton dhe publikon tarifën e shërbimeve të saj, të cilat miratohen nga organi epror.

Neni 41
Bashkëjetesa afatgjatë

Bashkëjetesa, nën një politikë dhe administrim të përbashkët dhe afatgjatë, ndërmjet qendrës së artit dhe kompanisë teatrore (ose të një personi tjetër juridik, privat apo shtetëror) bëhet me miratimin e pronarit të qendrës dhe mënyrat e bashkëjetesës pasqyrohen në një kontratë të posaçme, mbështetur në parimet e këtij ligji.

KREU V
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 42
Krijimi i kompanisë teatrore shtetërore qendrore të operas dhe baletit

Krijohet kompania teatrore shtetërore qendrore e operas dhe e baletit, me emërtimin “Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit”, me seli në Qendrën Kombëtare të Arteve, në varësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 43
Krijimi i Qendrës Kombëtare Teatrore të Operas dhe Baletit

Godina dhe infrastruktura e Teatrit të Operas dhe Baletit shndërrohet në Qendrën Kombëtare Teatrore të Operas dhe Baletit, në varësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 44
Krijimi i kompanisë teatrore shtetërore të artit dramatik

Krijohet kompania teatrore shtetërore e artit dramatik, me emërtimin “Teatri Kombëtar”, me seli në godinën e Qendrës Kombëtare Teatrore të artit dramatik, në varësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 45
Krijimi i Qendrës Kombëtare Teatrore të Artit Dramatik

Godina dhe infrastruktura e Teatrit Kombëtar shndërrohet në Qendrën Kombëtare Teatrore të Artit Dramatik, në varësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 46
Inventarizimi i qendrave të artit

Ngarkohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, që në bashkëpunim me Ministrinë e Pushtetit Vendor, të bëjë inventarizimin e përgjithshëm të qendrave të artit.

Ndërtesa dhe infrastruktura e teatrove kombëtare qendrore e vendore nuk mund të tjetërsohen dhe as të jepen në përdorim për qëllime joartistike.

Neni 47
Krijimi i kompanisë teatrore shtetërore qendrore të Ansambilit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve Popullore

Krijohet kompania teatrore shtetërore qendrore e Ansambilit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve Popullore me seli në Qendrën Teatrore Kombëtare të Teatrit të Operas dhe Baletit, në varësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 48

Krijohet kompania teatrore shtetërore qendrore e Teatrit Kombëtar për Fëmijë me seli në Teatrin e Kukullave të Tiranës, në varësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 49

Godina dhe infrastruktura e Teatrit të Kukullave shndërrohet në Qendrën Kombëtare Teatrore për Fëmijë, në varësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 50

Mbrojtja ekonomike e artistëve teatrorë

Artistët teatrorë, që si rezultat i zbatimit të këtij ligji humbasin vendin e punës në institucionet e mbyllura ose të shndërruara, gëzojnë të drejtën e mbrojtjes ekonomike nga shteti, në bazë të legjislacionit në fuqi.

Neni 51

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të miratojë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji jo më vonë se 90 ditë nga data e hyrjes në fuqi të tij.

Neni 52

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2562, datë 22.2.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani